


S4J
Aftësi për Punë
Skills for Jobs

RAPORT

Bashkëpunimi mes OJF – ve dhe shkollave profesionale në mbështetje të nxënësve nga grupet vulnerable

Qershor 2023

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Zbatuar nga:

swisscontact

Bashkëpunimi mes OJF – ve dhe shkollave profesionale në mbështetje të nxënësve nga grupet vulnerable

Qershor 2023

Ky raport është hartuar nga Veronika Duci, Profesor e Asociuar, nën kujdesin e Migena Kapllanaj, Projekti “Aftësi për Punë”.

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J: “Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE 4

1.1. RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT MES SHKOLLAVE DHE OJF – VE 5

1.2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA 5

2. KONTEKSTI I ARSIMIT PROFESIONAL NË SHQIPËRI DHE ROLI I OJF - VE 6

2.1. SHKOLLAT E ARSIMIT PROFESIONAL 6

2.2. OJF – TË DHE NDËRLIDHJA E TYRE ME ARSIMIN 6

2.3. SITUATA AKTUALE E MBËSHTETJES SË NXËNËSVE NGA GRUPET VULNERABLE - SFIDAT 7

3. SI MUND TË NDIHMOJNË OJF – TË? 9

4. ÇFARË FORME MUND TË MARRË PARTNERITETI? 12

5. HISTORI TË SUKSESSHME 13

6. SFIDAT DHE BARRIERAT – SI MUND TË KAPËRCEHEN? 14

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME 16

8. REFERENCAT 18

BURIMET E KONSULTUARA 19

1. HYRJE

Nxënësit që u përkasin grupeve vulnerable kanë mundësi të pabarabarta për të aksesuar sistemin arsimor si dhe për të patur një arsimim cilësor dhe të krahasueshëm me atë të bashkëmoshatarëve të tyre. Ky fakt çon në një shkallë më të lartë braktisjes së shkollës ose mosarritjen e kompetencave të mjaftueshme për të hyrë në tregun e punës. Rrjedhimisht, problematikat e tyre fillestare përjetësohen dhe mundësia për përfshirje sociale minimizohet. Ky rrezik është më i pranishëm në shkollat e arsimit profesional, të cilat tradicionalisht janë preferuar nga kategoritë e nxënësve që u përkasin grupeve vulnerable si një mënyrë për të hyrë më shpejt në tregun e punës, të pajisur me një profesion.

Në arenën ndërkombëtare, arsimi për të gjithë ka qenë gjithmonë një pjesë integrale e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm, por ka fituar më shumë vëmendje në Agjendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, ku qëllimi i katërt i referohet: "*Sigurimit të arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, dhe promovimit të mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë*"[1]. Mundësimi aksesit në arsim dhe i një procesi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës është edhe pjesë përbërëse e OZHQ 4 dhe nënkupton krijimin e kushteve që të gjithë djemtë dhe vajzat, pavarësisht aftësive dhe karakteristikave të tjera, të vijojnë mësimet bashkë, duke bërë kujdes për nevojat individuale të tyre, diçka që është reflektuar dhe në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026 dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021 - 2026[2]. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësive 2023 – 2030[3] thekson rëndësinë e arsimit profesional për të rritur mundësitë e punësimit dhe të partneritetit social në sektorin e punësimit dhe aftësive, duke përfshirë këtu dhe arsimin profesional. Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020 – 2023 sjell qasjen e re të integrimit dhe ndërlidhjes së shërbimeve të ndryshme sociale, arsimimit, strehimit, ndihmës ekonomike në natyrë (bonuse) apo tjetër ndaj përfituesve të Ndihmës Ekonomike, e cila duhet të zbatohet dhe në mjedisin arsimor[4]

[1] Kombet e Bashkuara (2015). Transforming our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development. Marrë nga: https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication e aksesuar në qershor 2023

[2] Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2021). VKM Nr. 659, datë 3.11.2021 "Për miratimin e Agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021–2026"

[3] Ministria e Financave dhe Ekonomisë (). VKM Nr. 173, datë 24.3.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024"

[4] Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2020). VKM Nr. 866, datë 24.12.2019 "Për miratimin e Strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj"

1.1. RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT MES SHKOLLAVE DHE OJF – VE

Përtej politikave kombëtare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve vulnerable, një rol të madh në këtë drejtim luajnë dhe Organizatat Jo – Fitimprurëse (OJF). Bashkëpunimi mes shkollave dhe OJF është shumë i rëndësishëm për të fuqizuar nxënësit që vijnë nga grupet vulnerable dhe për të promovuar shkolla dhe shoqëri më gjithëpërfshirëse. Shkollat profesionale dhe OJF – të kanë role të ndryshme dhe kontribuojnë në forma të ndryshme në shoqëri, por shpesh ky kontribut qëndron vetëm në fushën e veprimtarisë së secilit ose bazohet në aktivitete të veçuara dhe jo në një partneritet të qendrueshëm. Edhe pse vitet e fundit në Shqipëri arsimi profesional ka patur investim nga shteti shqiptar dhe nga donatorët e huaj dhe situata në të është përmirësuar ndjeshëm, sërish nuk ka një qasje sistemike dhe të qendrueshme që shënjestron nxënësit që u përkasin grupeve vulnerable brenda arsimit profesional.

Krijimi i sinergjisë mes shkollës dhe OJF – ve mund të mbështesë nxënësit e grupeve vulnerable në mënyrë më efektive, duke adresuar probleme sociale të hasura shpesh në shkolla profesionale për fëmijët që vijnë nga familjet e varfëra, për ata të minoritetit Rom ose Egjiptian, për fëmijët me nevoja të veçanta, për ata me një ose më shumë prind me një sëmundje kronike, për fëmijët pa kujdes prindëror dhe të tjerë.

1.2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij dokumenti është të eksplorojë rëndësinë e bashkëpunimit mes OJF – ve dhe shkollave të arsimit profesional për mbështetjen dhe fuqizimin e nxënësve që vijnë nga grupet vulnerable. Dokumenti thekson rëndësinë e partneriteteve të qendrueshme mes shkollave dhe OJF – ve dhe argumenton se duke u mbështetur në pikat e forta dhe burimet e secilit sector mund të krijohen sisteme gjithëpërfshirëse mbështetjeje që u vijnë në ndihmë nevojave të ndryshme të fëmijëve vulnerabël. Në kontrast me këtë, disa mendojnë se shkollat dhe sistemi arsimor në tërësi duhet të kenë sistemet e tyre të brendshme të qendrueshme të mbështetjes së këtyre nxënësve, pasi mbështetja tek OJF – të është sporadike dhe e paqendrueshme. Megjithatë, në këtë dokument do të argumentohet mundësitë e kapërcimit të këtyre sfidave dhe për përfitimet e këtij bashkëpunimi. Së fundmi, do të ofrohen rekomandime për përmirësimin dhe fuqizimin e këtij partneriteti.

Për të arritur qëllimin e këtij dokumenti është hulumtuar literatura shqiptare dhe e huaj për çështjen, si dhe janë realizuar dy intervista me drejtues të shkollave profesionale dhe dy takime në fokus grupe: (1) me stafin e njësisë psikolosociale në shkollat profesionale dhe me (2)

koordinatorët e njësisë së zhvillimit dhe përgjegjësit për koordinimin e projekteve brenda kësaj njësie. Gjithashtu, janë shqyrtuar dokumentet e projektit S4J të lidhura me 9 shkollat partnere të tij për aktivitetet që projektet që kanë implementuar ndër vite si dhe për shpeshtësinë dhe kategoritë e vulnerabilitetit në këto shkolla[5].

2. KONTEKSTI I ARSIMIT PROFESIONAL NË SHQIPËRI DHE ROLI I OJF - VE

2.1. SHKOLLAT E ARSIMIT PROFESIONAL

Arsimi dhe formimi profesional (AFP) në Shqipëri rregullohet me Ligjin nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", qëllimi i katërt i të cilit është të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në AFP. Shkollat e arsimit profesional, janë institucione ku nxënësit arsimohen dhe pajisen me kompetenca të përgjithshme dhe kompetenca profesionale. Në funksion të strukturës mësimore, nxënësit mund të punësohen pa përfunduar ciklin e plotë të arsimimit, ose kur e përfundojnë të plotë atë dhe kryejnë Maturën Shtetërorë, mund të ndjekin Arsimin e Lartë[6].

Shkollat e arsimit profesional mund të bëhen një mjedis mbështetës për nxënësit e grupeve vulnerable dhe të ndikojnë në zhvillimin social të një vendi. Për këtë arsye, aktivitetet dhe projektet me bazë shkollën në mbështetje të këtyre fëmijëve janë gjithnjë e më shpeshta duke menduar se shkollat janë "njësi kujdesi dhe mbështetjeje". [7]

Në shkollat profesionale partnere të projektit S4J në Shqipëri nga 5623 nxënës 15% (n = 861) vijnë nga familje që mbështeten me ndihmë ekonomike, 5% (n = 297) janë nga minoriteti Rom dhe Egjiptian, 3% (n = 159) janë jetimë dhe 2% (n = 91) janë fëmijë me nevoja të veçanta. Edhe pse nuk ka të dhëna për të krahasur këto numra me shkollat e tjera të arsimit të mesëm të lartë, sërish këto vlera mbeten të larta.

2.2. OJF – TË DHE NDËRLIDHJA E TYRE ME ARSIMIN

OJF – të mund të kategorizohen në disa grupe të mëdha që lidhen me fokusin që kanë dhe mënyrën me të cilën mund të bashëpunojnë me shkollat. Ato janë:

[5] Shkolla "Kolin Gjoka" në Lezhë, shkolla "Hamdi Bushati" në Shkodër, shkollat "Tregtare" dhe "Pavarësia" në Vlorë, shkolla "Kristo Isak" në Berat, shkolla "Gjergj Canco" dhe "Teknike Ekonomike" në Tiranë, shkolla "Salih Ceka" dhe "Ali Myftiu" në Elbasan.

[6] Shih http://www.vet.al/

[7] Symaco (2016). Education and NGOs. Bloomsbury Academic. E marrë nga https://www.bloomsburycollections.com/book/education-and-ngos/education-and-ngos-introduction e aksesuar në qershor 2023

(1) Organizata që kanë si përfitues direktë dhe kryesorë fëmijët. Fëmijët mund të jenë nga familje në të varfëra ose në vështirësi ekonomike, fëmijë nga minoriteti Rom ose Egjiptian, fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë emigrantë ose me familje të rikthyer nga migracioni, fëmijë në situate rruge, fëmijë që jetojnë në zona të largëta, fëmijë të trafikuar ose në rrezik trafikimi, fëmijë të dhunuar, në konflikt me ligjin, me probleme të shëndetit mendor etj.

(2) Organizata që kanë si përfitues kryesorë dhe direktë prindërit/familjet. Ata mund të jenë prindërit e fëmijëve të regjistruar në një shkollë specifike, prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, prindër në vështirësi ekonomike etj.

(3) Organizata që targetojnë mësuesit. Ata mund të jenë mësues të një lënde të veçantë ose të një fushe.

(4) Organizata mikse, të cilat kanë më shumë se një kategori përfituesish.[8]

OJF – të mund të kontribujnë në një sërë mënyrash në sistemin arsimor duke synuar politika më efektive, zhvillim të barabartë dhe rritje gjithëpërfshirëse. Ato kanë kapacitetin për të fuqizuar, përfaqësuar, mbrojtur dhe arritur grupet vulnerable. Gjithashtu, mund të përmirësojnë zhvillim ekonomik dhe njerëzor, kohezionin social dhe inovacionin[9]. Për shembull, në një nivel mikro duke punuar me shkollat një OJF mund të sjellë ndryshim me anë të procesit të inovacionit "nga poshtë lartë", i cili më vonë mund të përdoret gjerësisht. Publiku i gjerë shpesh i konsideron OJF – të si më të eficiente, më pak të korruptuara dhe më afër me komunitetin. [10]

Partneriteti mes shkollave të arsimit profesional dhe OJF – ve mund të ketë objektiva të ndryshme: mbështetjen në përmirësimin e aksesit dhe/ose mësimnxënien, këshillim, mbrojtje, parandalimi i braktisjes së shkollës, çështje që lidhen me shëndetin mendor, abuzimin me substanca narkotike, me konfliktin me ligjin, integrimin në komunitet ose në shkollë etj. Mund të jenë partneritete të orientuara nga parandalimi ose nga ndërhyrja[11].

2.3. SITUATA AKTUALE E MBËSHTETJES SË NXËNËSVE NGA GRUPET VULNERABLE - SFIDAT

[8] ibid

[9] European Training Foundation, ETF (26 shtator 2018). *New survey - Civil society: skills and vocational education*. E marrë nga https://www.etf.europa.eu/en/news-and-events/news/new-survey-civil-society-skills-and-vocational-education, e aksesuar në qershor 2023.

[10] Kieu, T.K. & Singer, J. (2017). Involvement of NGOs in Training Teachers in Education for Sustainable Development in Vietnam: A Case Study. *European Journal of Sustainable Development*, (6) 1: 153-166

[11] Stăiculescu, K.& Lacatuș, M.L. (3). School and Non-Governmental Organizations Partnership in Benefit of the Local Community. *Review of International Comparative Management,* (14) 3.

Bazuar në shqyrtimin e dokumenteve të projektit S4J dhe në intervistat dhe fokus grupet me stafin psikosocial dhe koordinatorët e njësisë së zhvillimit dhe të projekteve rezulton se aktualisht ka disa forma mbështetjetje nga shteti shqiptar për nxënësit që u përkasin grupeve vulnerable. Zakonisht, në fillim të vitit shkollor shkollat përgatisin hartën sociale për nxënësit në mënyrë që të kuptojnë llojin e vulnerabiliteteve të nxënësve. Kategoritë që ka harta sociale janë: fëmijët me aftësi të kufizuar, fëmijë që u përkasin një minoriteti (zakonisht Rom ose Egjiptian), fëmijë me që janë nga familje me ndihmë ekonomike, fëmijë jetimë pa njërin ose pa të dy prindërit, fëmijë që nuk janë nën kujdesin prindëror, fëmijë të trafikuar ose në rrezik trafikimi, me statusin e të verbërit, me një anëtar në familje me aftësi të kufizuar etj. Këto janë dhe kategoritë e fëmijëve që përfitojnë një lloj mbështetje nga shteti shqiptar për të lehtësuar vazhdimin e shkollës.[12]

Disa nga format e mbështetjes së nxënësve dhe familjeve të grupeve vulnerable nga shteti shqiptar janë:

- shtimi i 300 lekëve në muaj tek familjet që marrin ndihmë ekonomike nëse fëmijët e tyre frekuentojnë shkollën (bazuar në *VKM Nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike"*);
- rimbursimi i kostove të transportit për nxënësit që jetojnë më larg se 5km nga shkolla e tyre (sipas *VKM Nr. 682, datë 29.7.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit"*);
- mbështetja financiare me anë të bursave të bazuara në kriterin ekonomik ose në kriterin e rezultateve të arritura, bazuar në *VKM nr. 753, datë 13.12.2017 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018*";
- përfitimi i teksteve shkollore falas për 18 kategori nxënësish si: nxënësit që në arsimin parauniversitar i përkasin kategorisë së pakicave kombëtare, ata që kanë përfituar statusin e jetimit, nxënësit që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit, nxënësit me aftësi të kufizuara sipas ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", nxënësit që janë shtruar në Shërbimin Onkologjik, nxënësit që u përkasin pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane, etj. (bazuar në VKM nr. 486, datë 17.06.2020, "*Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar*"[13]

[12] ASCAP (2022). Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psikosocial shkollor. E marrë nga https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/Udhezuesi-i-SHPS.pdf, e aksesuar në qershor 2023; VKM nr. 486, datë 17.06.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar",

[13] Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (2021). VKM Nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"

- për nxënësit me aftësi të kufizuar parashikohet mbështetja nga mësues ndihmës për (bazuar në *VKM nr 26, dt 25.11.2019 "Për mësuesin ndihmës për nxënësin me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar*), dhe sigurimi i mjeteve didaktike të posaçme. Krahas tyre, në aspektin e mbrojtjes sociale fëmijët marrin pagesën për aftësinë e kufizuar dhe shërbime sociale dhe shërbime të specializuara, sipas nevojave të tyre, si p.sh. logopedi, fizioterapi etj.

Megjithatë, pavarësisht parashikimeve të mësipërme, rezulton se ende ka sfida për të ofruar në kohën e duhur përfitimet e mësipërme për kategori të ndryshme të nxënësve, ndërsa në disa raste të tjera ato nuk ofrohen fare. Nga diskutimi me stafet e njësisë psikosociale në shkolla rezulton se shpesh bursat që duhet të përfitojnë nxënësit jashtë kriterit ekonomik dhe rimbursimi i transportit bëhen shumë vonë, gati në fund të vitit shkollor. Kjo do të thotë se nxënësit që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike duhet të gjejnë një zgjidhje tjetër për të siguruar transportin dhe për të mbuluar nevojat e tjera shkollore që kanë përgjatë vitit. Përveç kësaj, për nxënësit me nevoja të veçanta nuk sigurohen gjithmonë mësuesit ndihmës e as mjetet e duhura didaktike. Në rastin e arsimit profesional sigurimi i këtyre mjeteve bëhet dhe më i vështirë duke qenë se mund të jenë të ndryshme për degë të ndryshme të arsimit profesional. Në të njëjtën kohë, aksesueshmëria e nxënësve me nevoja të veçanta fizike në shkolla nuk është arritur, infrastruktura e shkollave vazhdon të mbetet problematike[14]. Kësaj situate i shtohet dhe çështja e mjaftueshmërisë së këtyre mjeteve mbështetëse: për një familje që jeton me ndihmë ekonomike, vlera e se cilës është shumë e ulët, sa e ndryshon situatën e saj dhe të shkollimit të fëmijëve të saj rimbursimi i transportit ose marrja e një burse në fund të vitit shkollor?

3. SI MUND TË NDIHMOJNË OJF – TË?

OJF – të mund të luajnë një rol katalizator në plotësimin e nevojave të nxënësve që vijnë nga grupet vulnerable dhe në kapërcimin e pengesave të përmendura më sipër. Megjithatë, skeptikët paraqesin disa rreziqe nga ndikimi i madh që mund të kenë OJF – të në procesin e bashkëpunimit me shkollat, por edhe në procesin e dialogut dhe influencimit të politikave arsimore në një vend. Këto rreziqe bëhen më të dukshme në kontekste të vulnerabilitetit social, ku mekanizmi kryesor i OJF – ve i mbështetur në burimet financiare dhe materiale, është shumë më i nevojshëm për shtetin ose sistemin arsimor. Yemini dhe Sagie (2015) argumentojnë se OJF – të kanë prirjen të përdorin avantazhin e tyre financiar për të imponuar prioritetet e tyre tek shkollat, e sidomos tek ato shkolla

[14] Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2021). VKM nr. 276, datë 12. 5. 2021 "Për mirarimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025"

që funksionojnë në mjedise me burime të kufizuara[15]. Në raste të tjera, mund të jetë ekspertiza e zhvilluar e OJF – ve që arrin të argumentojë dhe të bindë shkollat për disa aktivitete që ndoshta ajo vetë nuk i kishte planifikuar[16].

Megjithatë, në shumë raste prioritetet e OJF – ve dhe të shkollave bien në të njëjtën fushë veprimi dhe dakordësie, prandaj bashkëpunimi mes tyre është kyç për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përbashkëta. Në këtë linjë, disa nga mënyrat me të cilat OJF – të mund të ofrojnë kontributin e tyre dhe të sjellin një impakt më të madh në jetën e nxënësve dhe të familjeve të tyre janë:

- Ofrimi i mbështetjes financiare, bursave ose ndihmës në natyrë: OJF – të kanë akses në burime financiare që mund të përdoren për të mbështetur financiarisht nxënësit e grupeve vulnerable që duan të ndjekin arsimin profesional. Shkollat mund të identifikojnë nxënësit më në nevojë (p.sh. ata që e kanë të vështirë të vazhdojnë shkollën nëse do e marrin bursën e ofruar nga pushteti vendor në fund të vitit shkollor) dhe bashkëpunojnë me OJF për të mbështetur këta nxënës. Gjithashtu, për such nxënësit me nevoja të veçanta OJF – të mund të ndihmojnë me sigurimin e mjeteve didaktike por edhe me teknologji ndihmëse.
- Ofrimi i shërbimeve përforcuese për mësimin: nxënësit që vijnë nga grupet vulnerable mund të kenë nevojë për mësim përforcues pas orarit të shkollës. Duke qenë se këto shërbime në Shqipëri zakonisht ofrohen nga qendra private dhe duhet të paguhen, fëmijët nga grupet vulnerable nuk arrijnë t'i aksesojnë. Këtë formë mbështetjeje mund ta marrin brenda mjedisit të shkollës pas përfundimit të mësimit (p.sh. kurse për lëndë të ndryshme) ose në një mjedis që e ofron OJF – ja.
- Mentorim dhe këshillim: OJF – të mund të ofrojnë programe mentorimi dhe këshillimi për nxënësit e grupeve vulnerable në arsimin profesional. Mentorët mund të ofrojnë udhëzime, mbështetje dhe motivim për të ndihmuar këta nxënës që të tejkalojnë sfidat dhe të marrin vendime të informuara për arsimimin e tyre dhe karrierën pas shkollës profesionale. Shkollat profesionale mund të ofrojnë hapësirën dhe burimet që të zhvillohen këto aktivitete të mentorimit. Vetë shkollat e arsimit profesional kanë programe mentorimi, por për shkak të ngarkesës së mësuesve nuk funksionojnë në mënyrë optimale. Një shembull këtu janë programet e mentorimit për fëmijët e minoritetit Rom ose Egjiptian të ofruara në vende të tjera, të cilat kanë qenë të suksesshme pasi mentorët nuk ofronin vetëm mbështetje dhe këshillim, por ata ishin rol – modele për këta nxënës[17].

[15] Yemini,M. dhe Sagie, N. (2015). School–nongovernmental organization engagement as an entrepreneurial venture: a case study of sunlight's engagement with Israeli schools. *Educational Administration Quarterly, 51 (4)*: 543-571.

[16] Verger, A. (2019). Partnering with non-governmental organizations in public education: contributions to an ongoing debate. *Journal of Educational Administration, 57 (4)*: 426-430: https://doi.org/10.1108/JEA-07-2019-224; Kolleck, N. (2019). The power of third sector organizations in public education. *Journal of Educational Administration, 57 (4)* fq. 411-425.

[17] Duci, V.& Dhembo, E. (2022). *Strategic Regional Policy Analysis in Western Balkans and Turkey: Secondary, Tertiary Education and Employability*. Roma Education Fund

- Mundësi praktike në biznes: shkollat e arsimit profesional kanë një sistem të konsoliduar të mundësimit të praktikës në biznes për shkollat dhe një/disa mësues – koordinatorë për këtë aspekt. Megjithatë, shpesh ata hasin vështirësi për caktimin e nxënësve në biznes. OJF – të mund të lehtësojnë këtë proces me identifikimin e bizneseve më të përshtatshme për praktikë për nxënësit nga grupet vulnerable dhe me advokimin tek to për bërjen e praktikave. Kjo mund të jetë shumë e nevojshme në rastet e nxënësve me nevoja të veçanta. Gjithashtu, OJF – të mund të ofrojnë mbështetjen e tyre përgjatë realizimin të praktikës: p.sh. për transportin e nxënësve me nevoja të veçanta nga shtëpia e tyre deri tek vendi i praktikës.
- Programe trajnimi për shprehi të punës: shkollat e arsimit profesional mund të bashkëpunojnë me OJF – të për të projektuar dhe ofruar programe trajnimi të shprehive të punës për nxënësit që vijnë nga grupet vulnerable, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre. Këto zakonisht janë shprehi që i ndihmojnë që të rritin mundësinë e punësimit të tyre, si p.sh. shprehi komunikimi, bashkëpunimi, shprehi për të shkruar një jetëshkrim, për të dhënë një intervistë pune etj.
- Ofrimi i shërbimeve të specializuara për nxënësit me nevoja të veçanta, me problematika të shëndetit mendor, për ata që kanë probleme të abuzimit me alkoolin ose substanca narkotike etj. Këto shërbime ofrohen në nivel vendor nga qendrat komunitare multidisiplinare, nga qendra qe ofrojnë shërbime të specializuara (p.sh. logopedi, fizioterapi, këshillim për probleme të shëndetit mendor etj), nga vetë stafi i njësisë psikosociale në shkollë dhe nga ofrues të tjerë shërbimesh publike. Në këto raste ato përfitohen falas. Nga ana tjetër, ndodh shpesh që të ketë një mbingarkesë në kërkesave për këto shërbime si në rastin e ngarkesës së psikologëve të shkollave, fëmijët mund të jetojnë larg nga qendra ku ofrohen ose thjesht nuk ofrohen. Duke qenë se disa OJF kanë ekspertizë disa – vjeçare në ofrimin e këtyre shërbimeve, ato mund të plotësojnë boshllëqet që krijohen në sistemin publik.
- Integrimi në tregun e punës, vendosja në një punë dhe mbështetja e vazhdueshme. OJF – të mund të ndihmojnë veçanërisht nxënës nga kategoritë vulnerable, si psh ata me nevoja të veçanta, të gjejnë një vend pune pasi të mbarojnë shkollën ose të angazhohen në një të tillë gjatë pushimeve të verës. Në këtë proces, mund të ofrojnë këshillim, mentorim etj.
- Start – ups dhe aktivitete të tjera të gjenerimit të të ardhurave: shkollat e arsimit profesional mund të bashkëpunojnë me OJF për projekte që nxisin sipërmarrjen dhe ndihmojnë në gjenerimin e të ardhurave. Për shembull, ato mund të ndihmojnë në themelimin e bizneseve të vogla (start - ups) me anë të konkurseve për idetë më të mira dhe me ofrimin e këshillimit përgjatë procesit të përgatitjes së idesë. Në këtë mënyrë, edhe nxënësit që nuk do fitojnë në konkurs fitojnë njohuri dhe shprehi sipërmarrëse.
- Realizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese: OJF – të mund të gjejnë një terren të favorshëm në shkollat e arsimit profesional për fushatat e tyre të ndërgjegjësimit për çështje të ndryshme, të lidhura me fushën e veprimtarisë së OJF – së. P.sh. ato mund të organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese kundër bullizmit, informim për rrezikun e trafikimit, sesione për

problemet e shëndetit mendor etj. Natyrisht, çështjet që do trajtohen duhet të lidhen dhe me nevojat e vetë shkollës.

- Ngritja e kapaciteteve të stafit pedagogjik dhe psikosocial të shkollës: mësuesit e shkollave profesionale kanë nevojë të herëpashershme për të përditësuar njohuritë e tyre në fusha të ndryshme, duke përfshirë këtu dhe mënyrën se si duhet të ndërveprojnë dhe të mbështesin fëmijët e grupeve vulnerable. P.sh. në Shqipëri, janë realizuar aktivitete të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve për përgatitjen e Planit Edukativ Individual, të cilat kanë qenë shumë të vlefshme për mësuesit dhe stafin psikosocial. Këto aktivitete mund të organizohen bazuar në një vlerësim paraprak të nevojave të mësuesve dhe të psikologëve dhe punonjësve socialë të shkollave[18].

4. ÇFARË FORME MUND TË MARRË PARTNERITETI?

Format më të shpeshta të partneriteteve mes shkollave të arsimit profesional dhe OJF – ve shtrihen në tri nivele: në kuadrin e një programi, mbi bazën e një projekti dhe për organizimin e aktiviteteve specifike.

(1) Partneriteti në kuadrin e një programi. Një program është një tërësi aktivitetesh të planifikuara, të kontrolluara dhe dinamike që përfaqëson një përqasje të integruar të lidhur me misionin dhe qëllimet e organizatës, zakonisht me një shtrirje afatgjatë. Ndryshe nga projektet, programet synojnë që të sjellin një sërë ndryshimesh të njëpasnjëshme ose të menjëhershme. Nuk është e thënë që të jetë i kufizuar në kohë, mund të jetë një proces afatgjatë dhe mund të përfshijë më shumë se një projekt. Donatorët që financojnë programet zakonisht nxjerrin disa herë thirrje për financim në nivel kombëtar ku shkollat mund të aplikojnë për projekte vetëm ose në partneritet me organizata të tjera. Organizatat që shkruajnë dhe hartojnë projekte për të aplikuar në programe konkurrojnë për fonde. Projekt – propozimet e tyre vlerësohen mbi bazën e kritereve specifike. Shkollat e arsimit profesional partnere të projektit S4J në Shqipëri kanë aplikuar në thirrje të ndryshme për projekte në fushën e arsimit profesional dhe disa prej tyre i kanë fituar. Megjithatë, nga lista e projekteve të implementuara shumë pak prej tyre fokusohen në grupet e nxënësve vulnerable. Nga diskutimi me stafin e njësisë psikosociale në shkolla u zbulua se shpesh ata përfshijnë nxënës nga grupe vulnerable në këto projekte, por sërish kjo nuk është një qasje e qendrueshme.

(2) Partneritet i bazuar në një projekt. Një projekt është një tërësi aktivitetesh që synojnë të adresojnë një problem spefik, kanë qëllime specifike, janë të kufizuara në kohë dhe në fondet që ofrojnë. Projektet zhvillohen hap pas hapi dhe mund të zbatohen nga vetë shkollat ose nga OJF – të tek shkollat dhe jashtë tyre, ose duke bashkëpunuar – shkolla, OJF dhe institucione të tjera, si

[18] Duci, V., Ndrio, M., Dragoti, E., Agolli, I. dhe Ismaili, E. (2016). *Facing the challenges of inclusive education*. UNICEF in Albania.

ato të pushtetit vendor. Shkolla mund të kërkojë për fonde dhe në këtë rast ajo do të jetë përfituese e projektit dhe përgjegjëse për zbatimin e tij dhe për arritjen e objektivave. Por, shumë shpesh ndodh që OJF – të kanë projektet e tyre të lidhura me grupet vulnerable dhe aksesin ose qëndrimin e tyre në shkollë dhe janë ato që kanë përgjegjësinë për të zbatuar projektin në bashkëpunim me shkollat.

(3) Partneritet për të realizuar aktivitete specifike kryesisht në nivel vendor, brenda ose jashtë shkolle. Këto aktivitete zakonisht marrin formën e sesioneve informuese, takimeve të hapura ose të tjera ku mund të përfshihen nxënësit dhe aktorë të tjerë të institucioneve vendore. Disa prej tyre lidhen me ditë/tematika të veçanta, si p.sh. kundër bullizmit, kundër trafikimit të qenieve njerëzore, informim për duhanpirjen, për sjelljen e shëndetshme etj.

5. HISTORI TË SUKSESSHME

Diskutimet në fokus grupet dhe intervistat zbuluan disa nga partneritetet e suksesshme mes shkollave të arsimit profesional dhe OJF – ve, të cilat kanë patur një impakt të rëndësishëm ne jetën e nxënësve. Vlen të përmendët fakti se ata sollën disa shembuj të suksesshëm bashkëpunimi, por janë përzgjedhur vetëm dy prej tyre të cilat kanë qenë me të zgjatura në kohë, dhe ka qenë më e lehtë që të identifikohen efektet pozitive të tyre.

- Bashkëpunimi me një OJF që kishte si fokus fëmijët me nevoja të veçanta (Shkolla Ali Myftiu/Salih Ceka dhe shoqata MEDPAK). Ky bashkëpunim ka konsistuar në realizimin e takimeve me prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta që në klasën e 9 – të dhe prezantimin e tyre me shkollat e arsimit profesional dhe mundësitë e shkollimit dhe punësimit e tyre më tej. Takimet janë bërë në shkollat 9 – vjeçare, me prindërit e fëmijëve dhe më pas me mësuesit e shkollave të arsimit profesional për mundësinë e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta. Takimet kanë vijuar dhe gjatë vitit shkollor, ndërsa në të njëjtën kohë OJF – ja kishte si qëllim që në fund të shkollimit të mundësonte punësimin e këtyre nxënësve, diçka që tregonte për vizionin afatgjatë dhe mundësitë më të mëdha që kishte kjo OJF në raport me ato të shkollës. Në fund, u hap një Zyrë Informacioni në Bashkinë Elbasan për prindërit dhe fëmijët me nevoja të veçanta, ku mund të marrin informacion për shkollimit dhe punësimin e tyre.
- Bashkëpunimi me një OJF që kishtë si fokus nxënësit nga minoriteti Rom dhe Egjiptian (Shkolla Ali Myftiu dhe Salih Ceka dhe Organizata Roma Versitas Albania). Bashkëpunimi ka konsistuar ofrimin e mbështetjes së nxënësve kryesisht nga minoriteti Rom (jo atyre nga minoriteti Egjiptian) me kurse pas – shkollore për lëndët që ata kishin vështirë, mbështetje me një bursë prej 4,000 lekë në muaj për frekuentimin e shkollës dhe ofrimin e ndihmës tek familjet e tyre. Gjithashtu, në periudhën Maj – Qershor OJF – ja bashkëpunonte me shkollën që të gjente nxënës që ishin në gjendje dhe të gatshëm të punonin dhe përpiqeshin t'iu gjenin një punë të përshtatshme për periudhën e verës. Për të

përfituar bursën dhe mbështetjen tjetër duhet të provonin frekuentimin e shkollës, me anë të mungesave. Sipas koordinatorit të njësisë së zhvillimit nxënësit jo vetëm rritën frekuentimin e shkollës por edhe ndryshuan notat në disa lëndë. Projekti ka zgjatur 3 vjet dhe u mbyll në Qershor në 2023.

Krahas tyre pjesëmarrësit përmendën iniciativa të tjera që kanë dhënë kontribut pozitiv tek nxënësit, si p.sh. trajnimi për realizimin e bizneseve sociale në fushën e konfeksioneve në Shkodër dhe investimi në krijimin e bizneseve sociale në bashkëpunim me projektin S4J, zbatimi i një projekti nga UNICEF me qëllim reduktimin e braktisjes, i cili ofron aktivitete jashtëshkollore falas me mbështetjen e projektit, mundësimi i pajisjeve digjitale etj. Duhet thënë se këto bashkëpunime kanë qenë më të shpeshta në Bashki si Shkodra, Elbasani, Lezha etj. por jo në Tiranë, ku siç duket numri i madh i shkollave dhe veçimi i shkollave të arsimit profesional nga ZVA – të minimizon mundësitë e këtyre bashkëpunimeve.

Elementët e përbashkët të iniciativave të suksesshme kanë qenë (a) kohështrirja e tyre – ishin për më shumë se një vit dhe shumë më tepër se një aktivitet, (b) adresimi i nevojave të nxënësve në një mënyrë holistike – ofrimi ndihmës financiare bashkë me kurset pas – shkollore, ndihmë për familjen dhe lehtësimi i punësimit (c) koordinimi i vazhdueshëm me shkollën për ecurinë e nxënësve – përfitues të projektit, dhe kërkesa e llogarisë për frekuentimin ose arritjet e tyre dhe (d) përfshirja dhe ndihmesa e dhënë ndaj familjes.

6. SFIDAT DHE BARRIERAT – SI MUND TË KAPËRCEHEN?

Diskutimet në dy fokus grupet e realizuara sollën në pah disa sfida në procesin e bashkëpunimit mes shkollave të arsimit profesional dhe OJF – ve. Disa nga këto sfida janë listuar më poshtë, së bashku më sugjerime për t'i kapërcyer:

- *Njohuri të limituara nga të dyja palët për rolin, aktivitetet dhe ekspertizën e njëri – tjetrit.* Kjo sfidë lidhet më shumë me shkollën përkundrejt OJF – ve. Stafi i njësisë psikosociale dhe koordinatorët e njësisë së zhvillimit pohuan se kishin një të kuptuar të fragmentuar të aktiviteteve të OJF – ve, të projekteve që ato kishin, të rolit dhe kontributit që mund të ofrojnë dhe të qëllimeve të tyre si organizatë. Kjo mungesë ndoshta nuk pengon realizimin e aktiviteteve të veçuara, si p.sh. ditët e informimit, mund të sjellë pengesa në krijimin e një partneriteti afatgjatë dhe të qendrueshëm. Për ta adresuar këtë sfidë të dyja palët duhet të investojnë në njohjen më të mirë të roleve dhe kapaciteteve të të dyja palëve. Zhvillimi i takimeve të rregullta, ëorkshop – eve dhe sesioneve për ndarje informacioni janë të rëndësishme për përditësimin e informacionit dhe forcimin e bashkëpunimit. Një rol të veçantë këtu mund të ketë pushteti vendor, pasi shpeshherë sektori i Shërbimit Social në Bashki bën një hartëzim të OJF – ve që kanë veprimtari në zonën e tyre dhe realizon takime dhe tryeza të rrumbullakëta. Këto takime mund të shërbejnë si pikënisje për njohjen e OJF – ve nga ana e shkollave profesionale, të cilët më vonë mund të vazhdojnë.

- *Objektiva dhe prioritete të ndryshme*. Shkollat e arsimit profesional fokusohen kryesisht në ofrimin e njohurive dhe arritjen e kompetencave teknike tek nxënësit, ndërsa OJF – të kanë një mision më të gjerë, që synon adresimin e çështjeve sociale. Balancimi i këtyre prioriteteve të ndryshme mund të jetë sfidues. Për shembull, koordinatorët e njësive të zhvillimit përmendën rastin e angazhimit të nxënësve në aktivitete të ndryshme të një projekti, diçka që kërkon një organizim të mirë nga ana e shkollës dhe nuk është gjithmonë e lejueshme që të largohen nga mësimi ose të marrin leje nga prindërit. Kjo i shton vështirësisë së koordinimit nga ana e shkollës, por nuk është e kuptueshme nga ana e OJF – ve. Dialogu i hapur mes dy palëve, diskutimi i pikave të takimit dhe vendosja e objektivave të përbashkëta për të mbështetur nxënësit nga grupet vulnerable ndihmojnë në kapërcimin e kësaj sfide.

- *Burime të kufizuara*. Edhe pse më përpara në këtë dokument u argumentua se OJF – të kanë më shumë burime financiare dhe njerëzore në raport me shkollat, sërish ato mbeten të kufizuara. Pritshmëritë e shkollave ndodh që janë të mëdha përballë mundësive reale që mund të ketë një OJF, pavarësisht dëshirës së mirë për të ofruar sa më shumë shërbime dhe mundësi për nxënësit e grupeve vulnerable. Nga ana tjetër, shkollat e arsimit profesional kanë kufizimet e tyre si financiare ashtu dhe njerëzore. Diskutimi në fokus grup me koordinatorët e njësisë së zhvillimit tregoi se ata kanë një ngarkesë shumë të madhe për koordinimin e projekteve, për të cilën nuk mjafton reduktimi i pakët i normës mësimore. Kufizime të tilla mund të pengojnë organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe të çojnë në organizimin e aktiviteteve sporadike, pa një strategji për impaktin që do të kenë. Në këtë moment, gjetja e mënyrave krijuese për të kapërcyer hendekun e burimeve njerëzore dhe financiare të kufizuara mund të sjellë ndryshim. Për shembull, OJF mund të aplikojë për projekte dhe financim së bashku me shkollën, ose mund të përdoren hapësirat e shkollës për organizimin e disa aktiviteteve duke reduktuar kështu kostot. Nga ana e shkollës, investimi në rritjen e stafit përgjegjës për shkrimin dhe zbatimin e projekteve është një domosdoshmëri.

- *Komunikimi dhe koordinimi*. Si në çdo bashkëpunim, edhe këtu komunikimi dhe mirë – koordinimi janë aspekte kritike për efektivitetin e tij. Ndryshime në kulturën organizacionale, në stilet e komunikimit dhe në mënyrat e koordinimit krijojnë probleme. Për shembull, stafi i njësisë psikosociale në shkolla përmendi faktin se OJF – të kur duan të organizojnë aktivitete ua komunikojnë momentin e fundit dhe ato nuk kanë kohë që të organizohen siç duhet. Një rast tjetër i vështirësisë në koordinim lind për shkak të faktit se shkolla e bën planifikimin e aktiviteteve që në fillim të vitit shkollor, ndërsa OJF – të kanë cikle të tjera dhe të ndryshme të zbatimit të projektit. Fleksibiliteti nga të dyja palët, vendosja e linjave të qarta të komunikimit, përcaktimi i pikave fokale brenda shkollës dhe OJF – së dhe përdorimi i platformave të komunikimit përmes teknologjisë për një

përditësim më të shpejtë të situatës mund të ndihmojnë për një komunikim efektiv dhe për një mirë – koordinim të bashkëpunimit.

- *Qendrueshmëria dhe angazhimi afatgjatë*. Bashkëpunimi mes shkollave dhe OJF – ve duhet të synojë të jetë afatgjatë në mënyrë që të ketë një impakt të qenësishëm në jetën e nxënësce. Megjithatë, kjo është një detyrë e vështirë, pasi kërkon angazhimin e të dyja palëve për një kohë të gjatë. Edhe pjesëmarrësit në intervista dhe fokus grupe pohuan se OJF – të kanë projekte afatshkurtra, të cilat mund të kenë një impakt pozitiv për aq kohë sa zbatohen, por më pas ndërpriten duke ndërprerë kështu dhe mbështetjen e dhënë. Njohja e nevojave të nxënësve të grupeve vulnerable të shkollave profesionale mund të ndihmojë në përditësimin/hartimin e projekteve të përshtatura sipas këtyre nevojave nga ana e OJF – ve. Gjithashtu, i rëndësishëm është nënshkrimi i marrëveshjeve formale që përcaktojnë rolet, përgjegjësitë dhe rezultatet e pritshme si dhe monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të projekteve në mënyrë që të identifikohen fushat për përmirësim.

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Partneriteti mes shkollave profesionale dhe OJF – ve në mbështetje të nxëënsve nga grupet vulnerable është një domosdoshmëri për të ofruar shprehi praktike, mbështetje arsimore, integrim brenda dhe jashtë shkollës dhe një mundësi më të mirë për punësim duke përmirësuar kështu perspektivën e tyre për një të ardhme më të mirë. Rekomandimet për të fuqizuar këtë bashkëpunim janë si më poshtë:

- **Identifikimi i nevojave të nxënësve që vijnë nga grupet vulnerable**. Shkollat e arsimit profesionale dhe OJF – të mund të krijojnë një platformë të përbashkët për identifikimin e nevojave të nxënësve që vijnë nga grupet vulnerable, e cila të ketë jnë vazhdimësi dhe të ndihmojë në vendosjen e prioriteteve dhe nevojës për ndërhyrje nga ana e OJF – ve. Këto nevoja mund të paraqiten në takime të rregullta që mund të organizohen nga shkollat ose nga OJF – të ku mund të gjenden pikat e përbashkëta.
- **Identifikimi i pikave të përbashkëta mes OJF - ve dhe shkollave të arsimit profesional**. Të dyja palët kanë si qëllim përmirësimin e shoqërisë dhe krijimin e një impakti pozitiv. Megjithatë, shpesh shkollat e arsimit profesional nuk janë shumë të njohura nga OJF – të duke qenë se operojnë në një mjedis tjetër në raport me shkollat e tjera të përgjithshme. Është akoma më e vështirë njohja e OJF – ve nga ana e shkollave të arsimit profesional. Prandaj, është e rëndësishme që në fillim të vitit shkollor ose më përpara të krijohet një urë komunikimi ose njohjeje të të dyja palëve.
- **Bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe Zyrat Vendore Arsimore (ZVA) për të lehtësuar procesin e njohjes dhe bashkëpunimit të mëtejshëm.** Shpesh, ZVA – të janë të informuara për aktorët e ndryshëm që operojnë në zonën e tyre, përfshirë dhe OJF – të.

Gjithashtu, drejtoritë e Sektorit Social në nivel Bashkie bëjnë një hartëzim të OJF – ve si dhe takime të rregullta për të përditësuar informacionin dhe për t'u njohur me veprimtaritë e parashikuara të OJF – ve në një vend. Shkollat e arsimit profesional mund të bashkëpunojnë me këto struktura për të qenë të informuara për veprimtarinë e OJF – ve.

- **Qasje proaktive nga shkollat e arsimit profesional mu për t'u njohur dhe për të paraqitur nevojat e tyre tek OJF – të e zonës së tyre dhe më tej.** Për shembull, ato mund të organizojnë ditë të hapura për të pritur dhe informuar OJF – të për situatën e shkollës së tyre, për nevojat e nxënësve që vijnë nga grupet vulnerable por edhe për kontributin e shkollës.
- **Përmirësimi i koordinimit të thirrjes për projekte nga Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA)**. AKPA luan një rol të rëndësishëm për njohjen e shkollave të arsimit profesional me mundësitë për thirrje për projekte në fushën e arsimit profesional. AKPA mund të luajë këtë rol dhe për projekte që lidhen me mbështetjen e nxënësve të grupeve vulnerable.
- **Krijimi i marrëdhënieve të qendrueshme me OJF – të për të patur një impakt më të madh tek jeta e nxënësve nga grupet vulnerable**. Shkollat e arsimit profesional duhet të synojnë të kenë bashkëpunime afatgjata me OJF – të, pasi në këtë mënyrë nxënësit përfitojnë më shumë. Për ta arritur këtë duhet të krijohen marrëveshje bashkëpunimi me to, ku të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë.
- **Krijimi i mundësive për të aplikuar së bashku me OJF – të për projekte që kanë interes të dyja palët.** Duke njohur më mirë funksionimin e OJF – ve dhe shkollave të arsimit profesional gradualisht ato mund të koordinojnë punën për të aplikuar në projekte të përbashkëta. Këtu mund të kombinohen ekspertiza e OJF – ve në shkrimin e projekteve me mundësitë që ofron shkolla për hapësira për organizimin e aktiviteteve të ndryshme si dhe me njohjen më të mirë të problematikave të nxënësve.
- **Fuqizimi i njësisë së zhvillimit dhe koordinatorit të projekteve brenda kësaj njësie.** Shkrimi i projekteve dhe zbatimi i tyre kërkon një kohë të konsiderueshme, e cila duhet të përkthehet në reduktimin e orëve mësimore për mësuesit përgjegjës. E njëjta gjë duhet të ndodh dhe për mësuesit e tjerë që angazhohen në shkrimin ose zbatimin e projekteve në shkollë.
- **Zbatimi më i gjerë i modeleve të suksesshme.** Nëse një iniciativë ka qenë e suksesshme në një shkollë, ajo mund të përsëritet dhe në shkolla të tjera të arsimit profesional.

8. REFERENCAT

- ASCAP (2022). Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psikosocial shkollor. E marrë nga https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/Udhezuesi-i-SHPS.pdf, e aksesuar në qershor 2023;
- Duci, V.& Dhembo, E. (2022). *Strategic Regional Policy Analysis in Western Balkans and Turkey: Secondary, Tertiary Education and Employability*. Roma Education Fund
- Duci, V., Ndrio, M., Dragoti, E., Agolli, I. dhe Ismaili, E. (2016). *Facing the challenges of inclusive education*. UNICEF in Albania.
- European Training Foundation, ETF (26 shtator 2018). *New survey - Civil society: skills and vocational education*. E marrë nga https://www.etf.europa.eu/en/news-and-events/news/new-survey-civil-society-skills-and-vocational-education, e aksesuar në qershor 2023.
- Kieu, T.K. & Singer, J. (2017). Involvement of NGOs in Training Teachers in Education for Sustainable Development in Vietnam: A Case Study. *European Journal of Sustainable Development*, (6) 1: 153-166
- Kombet e Bashkuara (2015). Transforming our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development. Marrë nga: https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication e aksesuar në qershor 2023
- Ligji nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"
- Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (2021). VKM Nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (). VKM Nr. 173, datë 24.3.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024"
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2020). VKM Nr. 866, datë 24.12.2019 "Për miratimin e Strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj"

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2021). VKM nr. 276, datë 12. 5. 2021 "Për mirarimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025"
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2021). VKM Nr. 659, datë 3.11.2021 "Për miratimin e Agjendës kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021–2026"
- Stăiculescu, K.& Lacatuş, M.L. (3). School and Non-Governmental Organizations Partnership in Benefit of the Local Community. *Review of International Comparative Management, (14) 3*.
- Symaco (2016). Education and NGOs. Bloomsbury Academic. E marrë nga https://www.bloomsburycollections.com/book/education-and-ngos/education-and-ngos-introduction e aksesuar në qershor 2023
- Verger, A. (2019). Partnering with non-governmental organizations in public education: contributions to an ongoing debate. *Journal of Educational Administration, 57 (4)*: 426-430: https://doi.org/10.1108/JEA-07-2019-224; Kolleck, N. (2019). The power of third sector organizations in public education. *Journal of Educational Administration, 57 (4)*: 411-425.
- VKM nr 26, dt 25.11.2019 "Për mësuesin ndihmës për nxënësin me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar
- VKM nr. 486, datë 17.06.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar",
- VKM Nr. 682, datë 29.7.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit
- VKM nr. 753, datë 13.12.2017 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017 – 2018"
- VKM Nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike"
- Yemini, M. dhe Sagie, N. (2015). School–nongovernmental organization engagement as an entrepreneurial venture: a case study of sunlight's engagement with Israeli schools. *Educational Administration Quarterly, 51 (4)*: 543-571.

BURIMET E KONSULTUARA

- UNITAR (2019). Leave No-One Behind: Bringing Vocational Education and Training to Vulnerable Populations, Concept Note. E marrë nga https://unitar.org/sites/default/files/media/file/LNOB%20Concept%20Paper%20.pdf e aksesuar në qershor 2023

- International Labour Office (2010). National Strategy on TVET Provision for Vulnerable People in Sri Lanka. E marrë nga https://planipolis.iiep.unesco.org/sites/default/files/ressources/sri_lanka_policy_tvet_vulnerable.pdf e aksesuar në qershor 2023
- Gupta, P.& Datta, A. (2023). The role of accurate identification of vulnerable youth in vocational education and training systems for improved employability: Insights from experimental data. Data in Brief, (48)
- Smile Foundation (Janar 2023). NGOs working for education. E marrë nga https://www.smilefoundationindia.org/blog/ngos-working-for-education/ e aksesuar në qershor 2023

- United States Agency for International Development, Bureau for Africa, Office of Sustainable Development (2003). Partnerships in education. Key Findings on the Role of NGOs in Basic Education in Africa. Sara project

- European Training Foundation (20 December 2019). Vocational education key to employability & preventing young people dropping out of school. E marrë nga https://www.etf.europa.eu/en/news-and-events/news/vocational-education-key-employability-preventing-young-people-dropping-out e aksesuar në qershor 2023